V E N D I M
Nr.133, datë 26.3.1993

PËR ÇELJEN E KURSEVE PËR PËRGATITJEN E PUNONJËSVE TË PROKURORISË, TË POLICISË HETIMORE DHE TË GJYKATAVE

Në zbatim të reformës në drejtësi, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çeljen e kursit tremujor për përgatitjen e punonjësve të prokurorive, të policisë hetimore dhe të kursit gjashtëmujor për përgatitjen e punonjësve të gjykatave.

2. Ministrisë së Drejtësisë, për përballimin e shërbimeve në organizimin e kurseve, i jepen 13 milionë e 200 mijë lekë, të cilat do të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në buxhetin e shtetit për vitin 1993.

3. Pjesmarrësit në këtë kurs do të trajtohen me ushqim e fjetje falas; atyre që shkëputen nga puna, të vazhdohet t'u jepet paga nga qendra e punës ku kanë qenë në marrëdhënie pune.

4. Shtëpia e pushimit e Ministrisë së Rendit Publik në Durrës, për vitin 1993, për veprimtaritë e mësipërme të përdorë tarifa në nivelin e mbulimit të kostos, pa llogaritur fitim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi